

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA TEKNIKE EKONOMIKE TIRANË

Nr. 1178 prot.

Data: 11.08.2025

Lënda: Njoftim për vënd të lirë.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr. 759 datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Zëvendës drejtor i kulturës profesionale

Kandidati aplikues për zëvendës drejtor i kulturës profesionale i shkollës Teknike Ekonomike Tiranë duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret të posaçme për zëvendës drejtorin, që mbulon kulturën profesionale:

- të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit "Master shkencor" (ose të barasvlershme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar";
- të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues publik të AFP-së;

- d. të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit;
- e. Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale të njërës prej drejtimeve mësimore të ofruesit publik të AFP-së.


2. Dokumentet e aplikimit

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 18.08.2025

DREJTOR

Dr. Anila Nanaj

